

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 591 Prot.

Tiranë, më 03.06 2016

VENDIM Nr. 54, datë 20.05.2016

Në mbështetje të **Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore"** (i ndryshuar), **VKM Nr. 725, datë 21.05.2008** "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë"(i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.6 të datës 20.05.2016, pasi shqyrtoi **Raportin e sondazheve arkeologjike** realizuar nga subjekti i licencuar "ABKONS" SH. P. K., për Sheshin e depozitimit të tubave Nr. 2 dhe kampin e punëtorëve Nr. 2 Floq-Korçë, **në kuadër të projektit të gazsjellësit TAP** dhe relacionin e mbikëqyrjes arkeologjike realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik,

VENDOSI:

1. Të miratojë **Raportin e sondazheve arkeologjike** realizuar nga subjekti i licencuar "ABKONS" SH. P. K., për Sheshin e depozitimit të tubave Nr. 2 dhe kampin e punëtorëve Nr. 2 Floq-Korçë, **në kuadër të projektit të gazsjellësit TAP** dhe relacionin e mbikëqyrjes arkeologjike realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.
2. Shoqëria "TAP-AG" duhet të lidhë paraprakisht kontratë tre palëshe me shoqërinë e licencuar në arkeologji, e cila duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të ndërtimit të Sheshit të grumbullimit të tubave Nr. 2 dhe Kampit të e punëtorëve Nr. 2 në Floq, Korçë, **në kuadër të projektit TAP**, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë shoqëri.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të kontratës tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO